

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTEREVE FIER  
NOTER ARBEN B. TAHIRAJ  
Nr 1358 rep.Nr 706 kol



**KONTRATE SHITBLERJE**  
**KUOTASH SHOQERIE TREGTARE ( SHPK )**

( Baza ligjore : Neni 705 e vijues i K.Civil )

Ne Fier sot me date **27 Korrik 2016 (dymije e gjashtembedhete)**, para meje Noterit ARBEN B. TAHIRAJ, ne studion time Noteriale te ndodhur ne Rr. Dervish Hekali, lagja "29 Nentori" Fier, u paraqiten personalisht shtetasit e meposhtem, te cilet me kerkuan redaktimin e kesaj " Kontrate Shitblerje Kuotash Shoqerie Tregtare " si me poshte vijon;

**PALA SHITSE:**

- **Z. Mariglent Vasil Marku**, i datelindjes 16.11.1976, lindur ne Fier dhe banues ne Raj. Nr.3, Fier, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar prej meje noterit nepermjet pasaportes me nr. BD4800802, nr. Personal H61116046N.

**PALA BLERESE :**

- **Z. Alket Mina Laro**, i datelindjes 29.12.1973, lindur ne Fier dhe banues ne lagjen Mbrostar Ferko, Fier, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar prej meje noterit nepermjet leternjoftimit me nr.027206658, nr. Personal H31229046J.

**OBJEKTI I KONTRATES**  
**SHITBLERJA E KUOTAVE TE SHOQERISE TREGTARE "KOMPAKT" SHPK**

**Z. Mariglent Marku** eshte nje nga ortaket e shoqerise "KOMPAKT" shpk, shoqeri e regjistruar prane Qendres Kombetare e Biznesit me NIPT K23407401F, me seli ne lagjen "Apollonia" Stacioni Hekurudhor- Fier.

- Pala Shitese me vullnet te lire deklarone se kuotat ne kapitalin themeltare te shoqerise qe ai posedon jane ne masen 2.44% (dy pike dyzet e kater), dhe me vullent te lire dhe te plote ia shet Z. Alket Laro.
- Cmimi i shitjes se kuotave per te cilen kane rene dakorte palet eshte 500.000 (peseqind mije) leke.
- Pala Blerese ne kete kontrate, Z. Alket Laro deklarone se eshte dakort te bleje kuotat e sipermendura te cilat perfaqesojne 2.44% (dy pike dyzet e kater) te kapitalit ne shoqerise "Kompakt" Sh.p.k.

**Palet bien dakort sa me poshte vijon:**

- Z. Mariglent Marku i shet pales blerese Z. Alket Laro, kuotat te cilat perfaqesone 2.44% (dy pike dyzet e kater) te kapitalit te shoqerise kundrejt cmimit 500.000 (peseqind mije) leke.
- Vlera e cila eshte likujduar totalishte nga pala blerese ne favore te pales shitese me leke ne dore ( CASH ), jashte kesaj zyre noterie.


## KUSHTET E KONTRATES

- Pala shitesë mban përgjegjësi për të gjithë dokumentacionin përkatës të pronësive mbi këto kuota të shoqërisë "KOMPAKT" shpk.
- Pala shitesë në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate heq dorë mbi çdo të drejtë pronësie mbi këto pjesë të kuotave, duke deklaruar se mbi to nuk ka të drejta pronësie dhe të drejta relative asnjë palë e tretë.
- Pala shitesë e garanton palën blerëse se këto kuota objekt kontrate janë plotësisht të lira nga çdo lloj barre penguese, detyrim ndaj të tretëve, ose sekuestrore mbi to.
- Pala shitesë i kalon palës blerëse pronësinë e plotë mbi këto pjesë të kuotave objekt kontrate, me të gjitha tagrat e pronarit të vetëm të tyre.
- Pala blerëse është në dijeni të statusit juridiko-financiar të shoqërisë "Kompakt" shpk, dhe se nuk do të ketë pretendime në të tashmen si dhe të ardhmen.
- Blerësi Z. Alket Laro bëhet pronar i 2.44 (dy pike dyzet e katër) % e kapitalit të shoqërisë "KOMPAKT" Sh.P.K të zotëruara deri tani nga shitesja Marigjent Marku.
- Pala shitesë, pas shitjes së kuotave largohet përfundimisht nga Shoqëria "KOMPAKT" shpk.

Kjo kontratë hartohet në 5 (pese) kopje origjinale të njëjta nga të cilat, një kopje duhet të depozitohet në Zyrën e Regjistrimit Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), një kopje duhet të depozitohet në selinë e shoqërisë dhe nga një kopje e merr secila palë.

Une noteri redaktoj këto kontrate të cilën palet pasi e lexojnë dhe e kuptojnë, e nënshkruajnë me vullnet të lirë dhe të plotë në prezencën time.  
Une noteri në bazë të ligjit për Noterine e vertetojë aktin rregullisht.

### **PALA SHITESË**

Marigjent Marku  


### **PALA BLERËSE**

ALKET LARO





**NOTER**  
**ARBEN B. TAHIRAJ**

